



- Lajmet e Fundit:
- DVP Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Skema”, për goditjen e skemave mashtruese që sjellin dëme të mëdha ekonomike

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Gledis Nano, për prezantimin e buxhetit të vitit 2022

Elbasan – Finalizohet operacioni policor i koduar “Rrajca 2021”

Pogradec – Goditen dy raste të veprimtarisë së paligjshme të prerjes së pyjeve, vihen në pranga 2 shtetas

Lezhë – Tentuan të vidhnin në banesën e një shtetasi, falë reagimit të shpejtë të Policisë, në bashkëpunim me banorët, kapet dhe vihet në pranga njëri nga autorët



Lajmet Operacionet

07/11/2021

Elbasan – Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Kalaja”

Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Kalaja”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje.

Operacioni i zhvilluar nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme dhe Seksioni i Forcës Operacionale në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Sekuestrohet një armë zjarri, municion luftarak dhe lëndë narkotike.

Vihen në pranga dy shtetas.

Në kuadër të planit të masave të hartuar nga DVP Elbasan, për rritjen e sigurisë publike, parandalimin e ngjarjeve të mundshme kriminale, kapjen e personave në kërkim dhe atyre që lëvizin me armë dhe lëndë narkotike, si rezultat i një hetimi 1-vjeçar, specialistët për Hetimit të Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Seksionin e Forcës Operacionale në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, zhvilluan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Kalaja”.

Si rezultat i këtij operacionit u bë ekzekutimi i masës së sigurimit personal “Arrest me burg”, për shtetasit Ardian Kaçaniku., 47 vjeç, dhe Edison Kaçaniku., 30 vjeç, banues në Elbasan.

Gjatë kontrollit të ushtuar nga shërbimet e Policisë në banesën e shtetasit A.K., u gjet dhe sekuestrua në cilësin e provës materiale: 1 armë zjarri pistoletë, fishekë luftarakë, 1 shkop hekuri me hapje me mbishkrimin “Police Using” , dhe 24 tableta të dyshuar metadon.

Më parë , në kuadër të këtij procedimi penal, nga shërbimet e Policisë janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale edhe një sasi lëndë narkotike e llojit heroinë e ndarë në doza dhe një 1 (një) armë zjarri pistoletë tip TT, me municion luftarak.

Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

